



KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. 67 dt. 13.2.2019

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME PËR ADMINISTRIMIN E LLOGARIVE, KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE, TË FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të Nenit 7 dhe Nenit 17 të ligjit Nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme për administrimin e llogarive, krijimin dhe përdorimin e të ardhurave, të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.
2. FSHZHD administron llogaritë në përputhje me legjislacionin financiar të kontabilitetit dhe raportimit financiar të parashikuar për institucionet publike.
3. Për financimet nga donatorë të huaj do të zbatohen standardet e raportimit sipas parashikimeve në marrëveshjen e financimit.
4. Burimet e financimit të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës janë përcaktuar në pikën 1, neni 7 të ligjit nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për zhvillimin e Diasporës”
5. Të ardhurat e FSHZHD-së janë të përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, dhe donatorëve të ndryshëm për financimin e projekteve të zbatuara nga FSHZHD-ja; fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave; individë e institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse; të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e veta dhe shërbimet e ofruara; kontributet materiale nga programet dy e shumëpalëshe, si dhe nga persona fizikë dhe organizata të ndryshme jofitimprurëse, që ushtrojnë aktivitet filantropik si dhe burime të tjera, të lejuara e të njohura nga legjislacioni në fuqi.



6. FSHZHD mban Kontabilitetin në përputhje me specifikat e institucionit, i cili të mundësojë:

- a) lehtësimin e auditimit dhe raportimin e projekteve/programeve;
- b) identifikimin e grupeve dhe nëngrupeve të kostos për të gjitha shpenzimet, me qëllim krahasimin fizik dhe monitorime të tjera;
- c) paraqitjen e shpenzimeve, sipas kategorive të kostos, si mirëmbajtje, mallra, shërbime këshillimi, trajnime, kosto operative, etj;
- d) paraqitjen e burimeve financiare sa herë që kërkohet;
- e) regjistrimin e aktiveve, pasiveve dhe fondeve të akumuluarra të projektit në grupe të caktuara.

7. FSHZHD ka planin e vet të llogarive të emërtuar dhe kodifikuar sipas legjislacionit në fuqi, në funksion të regjistrimit të transaksioneve sipas llojit, kategorisë, burimit të financimit dhe destinacionit të përdorimit të fondeve të krijuara;

8. Pasqyrimi në kontabilitet, i llogarive bankare, bëhet në monedhën bazë dhe në kundra vleftën në Lekë ose Euro.

9. Rimbushja e llogarive bëhet nga donatori nëpërmjet kërkesës për tërheqje fondesh.

10. Llogaritë bankare, e përfituara sipas pikës 1/b, të nenit 7 të ligjit 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, “për fondet nga buxheti i shtetit për projektet e financuara nga Këshilli i Ministrave”, çelen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për fondet buxhetore.

11. Llogaritë bankare, për të gjitha të ardhurat e tjera të krijuara sipas pikës 1 të nenit 7 të ligjit 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, çelen nga vetë FSHZHD, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në ligj.

12. FSHZHD në përputhje me marrëveshjen e financimit, çel llogari bankare të veçantë, “Diaspora për Diasporën”.

13. Fondet e kësaj llogarie do të përfitohen nga donacione të anëtarëve të diasporës, për shpenzime me karakter ekonomik, social-kulturor, shkencor e shëndetësor,

14. Të ardhurat e krijuara nga këto financime, do të administrohen nga FSHZHD, në përputhje me marrëveshjen e financimit, si dhe rregullat e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

15. Përdorimi i të ardhurave përcaktohet në varësi të burimit të krijimit të tyre, si më poshtë:

- a) të ardhurat e krijuara sipas nenit 7, gërma “a”, dhe “c”, të ligjit Nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, përdoren sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse.
- b) të ardhurat e krijuara sipas nenit 7, gërma “b”, e ligjit Nr. 32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, përdoren nëpërmjet sistemit të thesarit sipas rregullave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin buxhetor e financiar.
- c) të ardhurat e krijuara sipas nenit 7, pikat “ç”, dhe pika “dh”, depozitohen llogarinë bankare të Fondit.



16. Shpenzimet për auditimin e jashtëm nga shoqëri apo ekspertë të pavarur, të kërkuar nga Donatorët sipas përcaktimeve në marrëveshjen e financimit, do të mbulohet nga vetë Donatori.

17. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI
EDI RAMA**